

Çfarë është Smittestopp?

Smittestopp është një aplikacion nga Instituti Norvegjez për Shëndetin Publik (NIPH). I ka si synim të ndihmojë që koronavirusi të mos përhapet në shoqëri. Përdorimi i aplikacionit është me dëshirë.

Nëse bëni testin dhe zbulohet se keni koronavirus, mund t'u tregoni të tjerëve me anë të aplikacionit. Të tjerët do të vihen në dijeni nëse mund të jenë ekspozuar ndaj infeksionit dhe do të marrin këshilla se çfarë të bëjnë. Në këtë mënyrë, aplikacioni mund të parandalojë që të mos sëmuren edhe njerëz të tjerë. Aplikacioni nuk tregon nëse dikush është infektuar apo jo.

Si ta marr aplikacionin Smittestopp në telefonin tim?

- Shkarkoni aplikacionin nga App Store ose Google Play.
- Ndiqni udhëzimet që tregohen në ekranin e aplikacionit.
- Nëse nuk e kuptoni çfarë shkruhet, kërkoni dikujt që t'ju shpjegojë.

Si punon aplikacionin Smittestopp?

Sa herë që jeni pranë dikujt që e ka aplikacionin të instaluar në telefon, telefonat do të dërgojnë sinjale te njëri-tjetri.

Nëse një person tjetër del pozitiv me koronavirus, aplikacioni do të kujtohet që telefoni juaj ka qenë pranë personit të infektuar. Më pas do të merrni një mesazh me anë të aplikacionit për t'ju treguar se çfarë duhet të bëni. Gjithashtu mund të vendosni nëse doni t'i njoftoni apo jo të tjerët nëse jeni infektuar.

Nëse merrni një mesazh me anë të aplikacionit, do të zbuloni se jeni ekspozuar ndaj infeksionit, jo kush është infektuar apo ku. As autoritetet publike dhe as personat privatë nuk do të zbulojnë se kush jeni apo ku keni qenë.

Privatësia

- Duhet të jeni mbi 16 vjeç që ta përdorni Smittestopp.
- Të dhënat rreth jush do të fshihen pas 14 ditësh, pa pasur nevojë që të bëni diçka.
- Mund t'i fshini të dhënat rreth jush në aplikacion në çfarëdo kohe.
- Mund ta fshini aplikacionin në çfarëdo kohe.

**Hyni për të rikthyer jetën tuaj të
përditshme**